

V E N D I M
Nr. 434, datë 11.6.2001

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË BELGJIKËS PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE NË SITUATË TË PARREGULLT, SI DHE TË PROTOKOLLIT TË ZBATIMIT TË KËSAJ MARRËVESHJEJE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare" me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Belgjikës për ripranimin e personave në situatë të parregullt, si dhe të protokollit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

MARRËVESHJE

MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË BËLGJIKËS MBI RIPRANIMIN E PERSONAVE NË SITUATË TË PARREGULLT

(MARRËVESHJE RIPRANIMI)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës, duke dëshiruar të lehtësojnë ripranimin e personave me qëndrim të paligjshëm në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, p.sh. persona të cilët nuk i përmbushin më kushtet në fuqi për hyrje ose për qëndrim, si dhe për të lehtësuar kalimin tranzit të personave, në frymë të bashkëpunimit dhe mbi bazë të reciprocitetit.

Të quajtura më poshtë: "Palë Kontraktuese",

Kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

Përkufizimet dhe fusha e zbatimit

1. Në këtë Marrëveshje, me fjalën territor do të nënkuptohet ose do t'i referohet:
 - (1) me Republikën e Shqipërisë - territori i Republikës së Shqipërisë
 - (2) me Belgjikën - territori i Mbretërisë së Belgjikës.
2. Në këtë Marrëveshje, fjalët e mëposhtme do të kuptojnë:
 - (1) "vendi i tretë"- çdo vend me përjashtim të Republikës të Shqipërisë dhe të Mbretërisë së Belgjikës.
 - (2) "shtetas i një vendi të tretë"- çdo person i cili nuk është shtetas i Republikës së Shqipërisë ose i Mbretërisë së Belgjikës.
 - (3) "kufijtë e jashtëm":
 - (a) kalimi i kufirit të parë, i cili nuk është i përbashkët me Palët Kontraktuese;
 - (b) çdo aeroport ose port detar, vendndodhja e të cilit është në territorin e Republikës së Shqipërisë ose në territorin e Mbretërisë së Belgjikës, te të cilat kryhet një lëvizje e personave të cilët vijnë ose kalojnë për një vend të tretë.

Neni 2

1. Secila Palë Kontraktuese do të ripranojnë në territorin e Shtetit të tij, me kërkesë të Palës

tjetër Kontraktuese dhe pa ndonjë formalitet, personat të cilët nuk i plotësojnë, ose nuk i plotësojnë me kushtet në fuqi të hyrjes ose të qëndrimit në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese, kur sigurohet se është provuar ose prezumohet se ata kanë shtetësinë e Palës Kontraktuese të kërkuar. E njëjta procedurë do të zbatohet për personat të cilët janë privuar nga shtetësia e Palës Kontraktuese së kërkuar që nga hyrja në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese, të paktën pa iu premtuar natyralizimi nga Palët Kontraktuese kërkuese.

2. Në bazë të kërkesës së Palës Kontraktuese kërkuese, dhe në përputhje me nenin 3, Pala Kontraktuese e kërkuar, pa asnjë vonesë, do t'i lëshojë personave që do të ripranohen dokumentet e udhëtimit të nevojshme për pranimin e tyre.

3. Palët Kontraktuese kërkuese do të ripranojë këto persona përsëri me të njëjtat kushte, nëse nga verifikimet e mëtejshme rezulton se ata nuk e kanë më shtetësinë e Palës Kontraktuese së kërkuar në momentin që ata janë larguar nga territori i Palës Kontraktuese kërkuese. Kjo nuk do të zbatohet në rast se detyrimi i ripranimit është bazuar mbi faktin se Pala Kontraktuese e kërkuar e privon personin në fjalë nga shtetësia e tij saj, pasi ky person ka hyrë në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese pa i premtuar të paktën këtij personi natyralizimi nga Pala Kontraktuese kërkuese.

Neni 3

1. Identiteti dhe shtetësia e personit që do të ripranohet në bazë të procedurave të paragrafit 1 të nenit 2 mund të themelohen me anë të dokumenteve të mëposhtme:

- dokument identiteti kombëtar të vlefshëm;
- pasaportë të vlefshme ose dokument udhëtimit me fotografi, leje kalimi që zëvendëson një pasaportë;
- një dokument të vlefshëm ushtarak ose ndonjë dokument tjetër identiteti të personelit të forcave të armatosura me fotografi të mbajtesit;
- një dokument siç është përshkruar më lart, vlefshmëria e të cilit ka skaduar datën e marrjes së kërkesës për ripranim.

2. Identiteti dhe shtetësia prezumohen të vlefshme në bazë të dokumenteve të mëposhtme:

- një dokument zyrtar, jo i ngjashëm me ato të përshkruara në paragrafin më lart, i cili mundëson themelimin e identitetit të personit në fjalë, (patenta e makinës ose të tjera);
- një dokument që vërteton një regjistrim konsullor, një certifikatë shtetësie ose një certifikatë të gjendjes civile.

3. Prezumimi i identitetit ose i shtetësisë, gjithashtu, mund të mbështetet/shoqërohet me një nga elementet e mëposhtme:

- Një raport të një dëshmitari të besueshëm, themeluar nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese;
- fotokopje të dokumenteve të përshkruara më lart;
- proces-verbal të intervistës së personit në fjalë, të themeluar nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese;
- gjuha në të cilën shprehet personi në fjalë.

Neni 4

Paraqitja e kërkesës për ripranim

1. Çdo kërkesë për ripranim duhet të bëhet me shkrim dhe të përmbajë:

(a) të dhënat personale të personit në fjalë (mbiemrin, mbiemrat e mëparshëm, emrin, pseudonimet, aliaset, datën dhe vendin e lindjes, seksin dhe vendbanimin e fundit);

(b) një përshkrim të pasaportës ose të dokumentit të udhëtimit që zëvendëson atë (ku të shkruhen numri i serisë, vendi dhe data e lëshimit, data e vlefshmërisë, autoriteti i lëshimit) dhe/ose ndonjë provë tjetër dokumentare, e cila themelon ose provon shtetësinë në fjalë;

c) dy fotografi identiteti.

2. Pala Kontraktuese kërkuese mund t'i paraqesë Palës Kontraktuese të kërkuar çdo element tjetër informacioni, i cili mund të jetë i dobishëm për procedurën e ripranimit.

3. Kërkesa për ripranim do të depozitohet nëpërmjet kanaleve diplomatike ose konsullore të

Palës Kontraktuese të kërkuar dhe do të përmbajë dokumentet e përmendura në kërkesën e ripranimit. Një procesverbal i depozitimit/marrjes së kërkesës dhe të dokumenteve të përfshira në kërkesë duhet të përpilohet.

Neni 5 **Afatet kohore**

1. Pala Kontraktuese e kërkuar do t'i përgjigjet kërkesave për ripranim të adresuara tek ajo pa asnjë vonesë dhe, në çdo rast, në maksimum brenda pesë ditësh.

2. Pala Kontraktuese e kërkuar do të ripranojë pa asnjë vonesë dhe për çdo rast, në maksimum brenda një muaji, personat për ripranimin e të cilëve është rënë dakord. Në bazë të kërkesës nga Pala Kontraktuese kërkuuese, ky afat kohor mund të shtyhet për aq sa e kërkojnë pengesat ligjore ose praktike.

Neni 6 **Afati kohor pas të cilit detyrimi për ripranim do të skadojë**

Kërkesa për ripranim të një shtetasi të Shtetit të njëres prej Palëve Kontraktuese mund të bëhet në çdo kohë.

Neni 7 **Tranziti**

1. Pa paragjykuar nenin 11, Palët Kontraktuese do të lejojnë shtetas të një vendi të tretë që të kalojnë përmes territorit të tyre, nëse Pala tjetër Kontraktuese kërkon kështu, dhe nëse pranimi nga Shtete të tjera të mundshme të tranzitit dhe nga Shteti i destinacionit është garantuar.

2. Nuk është e domosdoshme për Palën Kontraktuese të kërkuar të lëshojë një vizë tranzit.

3. Pavarësisht nga ndonjë autorizim i lëshuar, personat e pranuar për qëllime tranzit mund t'i kthehen Palës tjetër Kontraktuese, nëse kushtet e parashikuara në nenin 11 janë të natyrës që pengojnë tranzitin ose nëse vazhdimi i udhëtimit ose pranimi në vendin e destinacionit nuk janë të garantuara më.

4. Palës Kontraktuese do të përpiqen të kufizojnë kalimet tranzit, siç janë përshkruar në paragrafin 1 sa më sipër për të huajt, të cilët nuk mund të kthehen direkt në vendet e tyre të origjinës.

Neni 8 **Mbrojtja e të dhënave**

Duke patur parasysh se zbatimi i kësaj Marrëveshjeje kërkon komunikimin e të dhënave personale, informacionet e transmetuara duhet të përmbajnë vetëm:

(1) të dhëna personale të personit që do të dorëzohet dhe kur është e nevojshme, të anëtarëve të familjes së personit (mbiemri, emri, eventualisht mbiemra të mëparshëm, pseudonime, aliase, data dhe vendi i lindjes, seksi, shtetësia aktuale dhe eventualisht ajo e mëparshme);

(2) pasaporta, karta e identitetit dhe dokumentet të tjera udhëtimi (numri, kohëzgjatja, data e lëshimit, autoriteti dhe vendi i lëshimit);

(3) të dhëna të tjera të nevojshme për identifikimin e personit që do të dorëzohet;

(4) vendet e qëndrimit dhe itinerari i udhëtimit;

(5) lejet e qëndrimit ose vizat e lëshuara nga njëra prej Palëve Kontraktuese.

Neni 9 **Shpenzimet**

1. Shpenzimet e transportit të personave që do të ripranohen në bazë të nenit 2 dhe 3 do të mbulohen nga Pala Kontraktuese kërkuuese deri tek kufiri i Palës së Kërkuar.

2. Shpenzimet e tranzitit deri tek kufiri i Shtetit të destinacionit dhe, kur është e nevojshme, shpenzimet që duhen për transportin e kthimit do të mbulohen nga Pala Kontraktuese kërkuuese, në

përputhje me nenin 7.

Neni 10

Komiteti i ekspertëve

1. Palët Kontraktuese do të ndihmojnë njëra-tjetrën për zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim, ato do të krijojnë një Komitet të Ekspertëve:

- a) për të ndjekur zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;
 - b) për të paraqitur propozime për zgjidhjen e problemeve që kanë lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;
 - c) për të propozuar amendamente dhe shtesa për këtë Marrëveshje;
 - d) për të përgatitur dhe rekomanduar masat e duhura për të luftuar imigracionin e paligjshëm.
2. Palët Kontraktuese do të rezervojnë të drejtën për të miratuar ose jo masat e rekomanduara nga Komiteti.

3. Komiteti do të përbëhet nga tre përfaqësues për Republikën e Shqipërisë dhe tre përfaqësues për Mbretërinë e Belgjikës. Palët Kontraktuese do të emërojnë një kryetar dhe zëvendësat e tij nga këta përfaqësues dhe, gjithashtu, do të emërojnë anëtarë alternativë. Ekspertë të tjerë mund të thirren për konsultime.

4. Komiteti do të mbledhet me iniciativën e njërës prej Palëve Kontraktuese, të paktën një herë në vit.

Neni 11

Klauzola e moscenimit të konventave/marrëveshjeve ndërkombëtare

Kjo Marrëveshje nuk do të cenojë detyrimet e Palëve Kontraktuese që rrjedhin prej:

1. Konventës së 28 Korrikut 1951 mbi Statusin e Refugjatëve, të amenduar nga protokollin i 31 janarit 1967 mbi Statusin e Refugjatit;
2. konventave ndërkombëtare mbi ekstardimin dhe tranzitin;
3. Konventës së 4 nëntorit 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore;
4. të drejtës së Bashkimit Europian për Mbretërinë e Belgjikës;
5. Marrëveshjes Shengen midis Qeverisë së Shteteve të Bashkimit Ekonomik të Beneluksit, Republikës së Gjermanisë dhe Republikës së Francës mbi heqjen graduale të kontrolleve në kufijtë e përbashkët dhe Konventës për zbatimin e Marrëveshjes Shengen të 19 qershorit 1990;
6. konventave ndërkombëtare mbi azilin, në veçanti prej Konventës së Dublinit të 15 qershorit 1990, ku përcaktohet Shteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për azil në një nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian;
7. konventave ndërkombëtare dhe marrëveshjeve mbi ripranimin e shtetasve të huaj.

Neni 12

Protokolli i zbatimit

Të gjitha dispozitat praktike të nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë të parashikuara në Protokollin e zbatimit.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë, pas marrjes së njoftimit të fundit për përmbushjen e formaliteteve të brendshme, të nevojshme për hyrjen në fuqi.

Neni 14

Pezullimi dhe denoncimi

1. Kjo Marrëveshje qëndron në fuqi për një periudhë të pacaktuar.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës mund të pezullojnë këtë Marrëveshje, pas dhënies së njoftimit për arsye të rëndësishme, në veçanti për arsye të ruajtjes së sigurisë së Shtetit, të rendit publik ose të shëndetit publik. Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën pa asnjë vonesë nëpërmjet rrugëve diplomatike mbi heqjen e një mase të tillë.

3. Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës mund të denoncojnë këtë Marrëveshje për arsye të rëndësishme, pasi kanë dhënë njoftimin.

4. Pezullimi ose denoncimi i kësaj Marrëveshjeje do të ketë efekt në ditën e parë të muajit të dytë pas ditës kur Pala Kontraktuese ka marrë njoftimin nga Pala tjetër Kontraktuese, referuar respektivisht paragrafit 2 dhe 3.

Neni 15

Përfaqësuesit e Palëve Kontraktuese, plotësisht të autorizuar për këtë qëllim, kanë vendosur firmat e tyre në fund të kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Tiranë më 17 prill në gjuhët shqip dhe frëngjisht, secili nga të dy tekstet konsiderohet i barazvlershëm.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë e Mbretërisë së Belgjikës